



V E N D I M

K.P.P.734/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-73369-06-05-2018 me objekt “Mirëmbajtje me performancë K/Sauk–Senatorium, K/Sauk – Ibë, Ibë – Qafë Krrabë (Km 29), Qafë Krrabë (Km 29) – rot. re Shijon, rot. re Shijon – Ura e Zaranikës, K/Km 22 – Qytezë Krrabë, Qytezë Krrabë – Pika Sipër Radio, Degëzim Miniera – Objekti X, Rotondo Sauk – Sauk i Vjetër, Tiranë – Ndroq – Romanat (Kufi Durrës), Romanat (kufi TR) – Plepa, Ura e Farkës – Qendër Fshat Baldushk, Qendër Fshat Baldushk – Mustafa Koçaj , K/Rr. Nr. 56 (Vaqqarr) – Vishaj (k/Baldushk) (116.25 km) (Kontrata 3)”, me fond limit 53.431.283 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë.

Ankimues:

“Nika” shpk
Rruga “Bulevardi Skënderbeg”, pas kinema Millenium Shkodër.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Rajonit Qëndror Tiranë
Rr.Princ Vidi nr.18/3 Tiranë

Subjekt i Interesuar:

“Victoria Invest” shpk
Lagjia “28 Nëntori”, Rruga “11 Nëntori”, pallati pranë tatim
taksave Elbasan

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 05.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73369-06-05-2018 me objekt “*Mirëmbajtje me performancë K/Sauk – Senatorium, K/Sauk – Ibë, Ibë – Qafë Krrabë (Km 29), Qafë Krrabë (Km 29) – rot. re Shijon, rot. re Shijon – Ura e Zaranikës, K/Km 22 – Qytezë Krrabë, Qytezë Krrabë – Pika Sipër Radio, Degëzim Miniera – Objekti X, Rotondo Sauk – Sauk i Vjetër, Tiranë – Ndroq – Romanat (Kufi Durrës), Romanat (kufi TR) – Plepa, Ura e Farkës – Qendër Fshat Baldushk, Qendër Fshat Baldushk – Mustafa Koçaj , K/Rr. Nr. 56 (Vaqarr) – Vishaj (k/Baldushk) (116.25 km) (Kontrata 3)*”, me fond limit 53.431.283 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë.

II.2. Në datën 09.07.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 30.07.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- B-93	pa ofertë	I skualifikuar
- Adem Pojani	pa ofertë	I skualifikuar
- Hastoçi	pa ofertë	I skualifikuar
- Bi-Servis	pa ofertë	I skualifikuar
- Nika	34,225,908	I skualifikuar
- Biba-X	45,948,290	I skualifikuar
- Jubica	47,000,000	I skualifikuar
- Alb Shpresa	47,300,000	I skualifikuar
- Sterkaj	48,322,115	I skualifikuar
- Alko Impex G.C	51,002,350	I skualifikuar
- Curri	52,101,936.30	I skualifikuar
- Victoria Invest	52,870,697.95	I kualifikuar

II.4. Në datën 30.07.2018 operatori ekonomik “Nika” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Borepastruese me targe , AA 645 HB , afati i kontrates , 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015, noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me te drejte perseritje ne te ardhmen . neni detyrimet te pergjithshme ; ”Me mbarimin e afatit te kontrates , palet do te bisedojne bashkarisht per vazhdimesine e metejshme te kontrates se qirase ...dhe kushteve te saj ” . Kjo kontrate noteriale nuk garanton kriterin e kerkuar ne dts*

” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi për permbushjen e kapacitetit për Borepastruese me targe , AA 645 HB.

- *Kontrata e qerases së fabrikës së asfaltit , afati i kontrates , 8289 rep dhe 4283 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me të drejtë perseritje në të ardhmen . neni detyrimet të përgjithshme ; ” Me mbarimin e afatit të kontrates , palet do të bisedojnë bashkërisht për vazhdimësinë e metejshme të kontrates së qirase ...dhe kushteve të saj ” . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi” . Pra kontrata e qerases 8289 rep dhe 4283 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi për permbushjen e kapacitetit për fabrikën e asfaltit .*
- *Kamioni me targe , AA 753 HB , afati i kontrates , 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me të drejtë perseritje në të ardhmen . neni detyrimet të përgjithshme ; “Me mbarimin e afatit të kontrates , palet do të bisedojnë bashkërisht për vazhdimësinë e metejshme të kontrates së qirase ...dhe kushteve të saj ” . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi për permbushjen e kapacitetit për Kamioni me targe me targe , AA 753 HB .*
- *Kamioni me targe , KO 0119 B , afati i kontrates , 7864 rep dhe 3005 kol , date 17.11.2017 , notere P.B , me afat nga data , 17.11.2017 , afati 2 vjet . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e*

qerese 7864 rep dhe 3005 kol , date 17.11.2017 , notere P.B nuk eshte e vlefshme e per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetit per Kamioni me targe , KO 0119 B.

- Freze , afati i kontrates , 1328 rep dhe 732 kol , date 09.07.2018 , notere B.B , me afat nga data, 09.07.2018, afati deri ne fund te vitit 2020 . Kjo kontrate noteriale nuk garanton kriterin e kerkuar ne dts ” Në rastin e mjeteve te tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizmi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerese/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi . Pra kontrata e qerese 1328 rep dhe 732 kol , date 09.07.2018 , notere B.B , megjithese eshte e vlefshme e per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetin per freze asfalti nuk eshte paraqitur dokumenti perkates qe mund te jene faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit te kerkuar ne dst
- Bitumatrice dhe makine vijezimii , afati i kontrates , 7487 rep dhe - kol , date 01.07.2016 , noter Shpresa Gjoci , me afat 01.07.2016 deri 01.07.2019 , afati 3 vjet . Kjo kontrate noteriale nuk garanton kriterin e kerkuar ne dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.” . Pra kontrata e qerese 7487 rep dhe - kol , date 01.07.2016 , noter Shpresa Gjoci nuk eshte e vlefshme e per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetit per Bitumatrice dhe makine vijezimi.

II.5. Në datën 02.08.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në lidhje me pretendimin se kontratat e qerasë respektive për mjetet e marra me qera nuk kanë afat vlefshmërie për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve sqarojmë se kjo është thjesht tendencë për skualifikim dhe jo arsye ligjore e cila eventualisht mund të cojë në mosrealizim të shërbimit të prokuruar. Nga ana jonë momentalisht janë të kontraktuara të gjitha mjetet dhe makineritë e kërkuara në këtë procedurë prokurimi. Ato janë të shoqëruara me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjor. Nëse ne do të shpallemi eventualisht fitues rrjedhimisht i bie që të jemi kontraktor të ardhshëm. Dhe duke qenë se kontrata përmban detyrime reciproke ne jo vetëm do të angazhohemi për të kryer shërbimin në mënyrën e duhur dhe sipas specifikimeve teknike por nga ana tjetër do kemi edhe angazhimin maksimal për të garantuar disponibilitetin e të gjitha mjeteve të

nevojshme. Të gjitha kontratat e qerasë që kemi përcaktojnë faktin se pas përfundimit të afatit të qerasë palët kanë të drejtë të përsërisin kontratën me të njëtat kushte të vecanta. Në këto kushte duke pasur aktualisht gjendjen në formën juridike dhe fizike të të gjitha mjeteve dhe makinerive të kërkuara në këtë procedurë prokurimi duke pasur njëkohësisht edhe detyrime eventuale në bazë të kontratës që mund të lidhet me institucionin tuaj si dhe duke pasur të gjitha të drejtat ligjore për të vazhduar kontratën e qerasë. Në sigurisht që do e bëjmë një të tillë dhe garantojmë realizimin e shërbimeve të prokuruar sipas projekt-preventivit dhe specifikimeve teknike. Duke qenë në këto rrethana mendojmë që vendimi i KVO duhet të rishikohet dhe shoqëria Nika të kualifikohet.

II.6. Me shkresën nr. 539 prot datë 07.08.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 17.08.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.570 datë 27.08.2018 protokolluar me tonën me nr.1411/2 datë 29.08.2018 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nika” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “Borepastruese me targe , AA 645 HB , afati i kontrates , 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015, noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me te drejte perseritje ne te ardhmen . neni detyrimet te pergjithshme ; ”Me mbarimin e afatit te kontrates , palet do te bisedojne bashkarisht per vazhdimesine e metejshme te kontrates se qirase ...dhe kushteve te saj ” . Kjo kontrate noteriale nuk garanton kriterin e kerkuar ne dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk eshte e vlefshme e per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetit per Borepastruese me targe , AA 645 HB.

Kontrata e qerases së fabrikës së asfaltit , afati i kontratës , 8289 rep dhe 4283 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me të drejtë perseritje në të ardhmen . neni detyrimet të përgjithshme ; ” Me mbarimin e afatit të kontratës , palet do të bisedojnë bashkërisht për vazhdimësinë e metejshme të kontratës së qirases ...dhe kushteve të saj ” . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi” . Pra kontrata e qerases 8289 rep dhe 4283 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi për përmbushjen e kapacitetit për fabrikën e asfaltit .

Kamioni me targe , AA 753 HB , afati i kontratës , 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha , me afat 22.10.2015 deri 22.10.2018 , afati 3 vjet me të drejtë perseritje në të ardhmen . neni detyrimet të përgjithshme ; “Me mbarimin e afatit të kontratës , palet do të bisedojnë bashkërisht për vazhdimësinë e metejshme të kontratës së qirases ...dhe kushteve të saj ” . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 8284 rep dhe 4278 kol , date 22.10.2015 , noter Napolon Vasha nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi për përmbushjen e kapacitetit për Kamioni me targe me targe , AA 753 HB .

Kamioni me targe , KO 0119 B , afati i kontratës , 7864 rep dhe 3005 kol , date 17.11.2017 , notere P.B , me afat nga data , 17.11.2017 , afati 2 vjet . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 7864 rep dhe 3005 kol , date 17.11.2017 , notere P.B nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi për përmbushjen e kapacitetit për Kamioni me targe , KO 0119 B.

Bitumatrice dhe makine vijezimi , afati i kontratës , 7487 rep dhe - kol , date 01.07.2016 , noter Shpresa Gjoci , me afat 01.07.2016 deri 01.07.2019 , afati 3 vjet . Kjo kontratë noteriale nuk garanton kriterin e kërkuar në dts ” Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.” . Pra kontrata e qerases 7487 rep dhe - kol , date 01.07.2016 , noter Shpresa Gjoci nuk është e vlefshme e për të gjithë periudhën e realizimit të

kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetit per Bitumatrice dhe makine vijezi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 pika 2.3.8 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. Si dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se zotëron :

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Mjet Germimi	ne pronesi ose me qera	cope 2
2.	Mjet Transporti vetëshkarkuese	ne pronesi ose me qera	cope 4
3.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 1
4.	Rrul vibrues	ne pronesi ose me qera	cope 1
5.	Prerese asfalti (sharre asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1
6.	Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 1
7.	Asfaltoshtruese	ne pronesi ose me qera	cope 1
8.	Makineri per sperkatje bitumi	ne pronesi ose me qera	cope 1
9.	Mjete per vendosje parrakesh metalik (guardraila) (Batipal)	ne pronesi ose me qera	cope 1
10.	Fabrike Asfaltobetoni	ne pronesi ose me qera ose me kontrate furnizimi	cope 1
11.	Skarifikuese (freze asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1
12.	Kamionçine ≥ 1.5 ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
13.	Mjet per vijezi me boje	ne pronesi ose me qera	cope 1
14.	Cilinder vibrues per mbushjen e gropave 1.5 – 2 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
15.	Mjet motorrik per prerjen e bimesise	ne pronesi ose me qera	cope 2
16.	Automjet borepastrues (APV) ose agregatë per pastrimin e bores dhe shperndares kripe me kamion ne	ne pronesi ose me qera	cope 2

	dispozicion		
--	-------------	--	--

*Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes **ose / dhe** kontratat e shitblerjes **ose / dhe** aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale , faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes **ose /dhe** aktet e zhdoganimit.*

Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit) .

III.1.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi janë bërë ndryshimet si më poshtë:

*Nën pika 2.3.8 e kapacitetit teknik , **ishte** : “ Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes **ose / dhe** kontratat e shitblerjes **ose / dhe** aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale , faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes **ose /dhe** aktet e zhdoganimit. Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit) . ”*

*Nënpika 2.3.8 e kapacitetit teknik , **ndryshohet** : “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit. Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qira/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi ”.*

III.1.3. Në seksionin 1 pika 2.9 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2. 9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 24 ose ditë ☐☐☐☐

ose duke filluar nga lidhja e kontratës me përfundim në 24 muaj kalendarik .

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Nika” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipërnë drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së makinerive Borepastruese, fabrikes se asfaltit, Bitumatrice dhe makine vijezimi”, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcë mbi disponimin e makinerive në të cilën ka deklaruar si vijon: *Fabrikë AsfaltoBetonit me kontratë qeraje Nr.8289/4283 dataë 22.10.2015-22.10.2018, Borëpastruese me targë SH6271E në pronësi sipas lejes së qarkullimit +faturë, Borëpastruese me nr.AA 645HB me qera me kontratën nr.8284/4278 datë 22.10.2015-22.10.2018, Makineri Vijëzimi, Bitumatrice me qera me nr.7487 datë 01.07.2016-01.07.2019*
- Kontratë Qeraje Nr. 8289 rep Nr.4283 Kol datë 22.10.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë Malësia Ventur në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënia me qera e Linjës së inerteve dhe fabrikës së Asfalto Betonit me nr.pasurie 189/2 dhe me lejen mjedisore përkatëse. Koha e dhënies me qera do të jetë 3 vjet me të drejtë përsëritje në të ardhmen kohë e cila fillon sot më datën e nënshkrimit të kësaj kontrate 22.10.2015 deri më datë 22.10.2018.
- Kontratë Qeraje Nr.8284 Rep Nr.4278 Kol datë 22.10.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë Alba Beton 07 shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënie me qera të mjeteve: Kamion me targa AA645HB, Autopompë Betoni, Autobetoniere, Eskavator, Gurrëthyes, Tërheqës, Fadromë, gjysëm rimorkio, me afat 3 vjecar 22.10.2015-22.10.2018. Koha e dhënies me qera do të jetë 3 vjet me të drejtë përsëritje në të ardhmen kohë e cila fillon sot më datën e nënshkrimit të kësaj kontrate 22.10.2015 deri më datë 22.10.2018.
- Kontratë Qeraje datë 01.07.2016 lidhur ndërmjet shoqërisë Shqiponja në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt Bitumatrice sipas faturës nr.28 datë 25.06.1999, Makinë Vijëzimi sipas faturës datë 05.06.1999, me afat 3 vjecar nga data 01.07.2016-01.07.2019.
- Kontratë qeraje Nr.7864 Rep, Nr. 3005 Kol datë 17.11.2017 lidhur ndërmjet shoqërisë Millenium shpk dhe shoqërisë Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit, me objekt dhënia me qera e mjeteve : Kamion me targa KO 9407 B, KO 0119B. Me marrëveshje mes palëve afati i kësaj kontrate mund të zgjatet.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti

kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”

III.1.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon ”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantëtë kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e kapaciteteve teknike lidhur me mjetet: Fabrike Asfaltbetoni, Automjet borepastrues (APV) ose agregatë për pastrimin e bores dhe shperndares kripe me kamion ne dispozicion, Mjet për vijejzim me boje, Makineri për sperkatje bitumi.

Gjithashtu në kriter kërkohet shprehimisht se për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit. Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi ”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Nika” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kapaciteti ankimesi ka parqitur shtojcën mbi disponimin e makinerive në të cilën deklaron se ka mjete në pronësi dhe mjete të marra me qera.

Konkretisht ka deklaruar se disponon në pronësi të tij mjetin borëpastrues me targa SH 6271E dhe ka marrë me qera me anë të kontratës Nr.8284/4278 të sipërcituar borëpastruesen me targa AA645 HB i cili sikundër rezulton nga dokumentacioni që e shoqëron kontratën është një kamion me të gjitha agregatet e nevojshme pastrimin e bores dhe shperndares kripes në përputhje me kriterin

kualifikues duke përmbushur kështu kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e dy borëpastrueseve.

III.1.7. Gjithashtu KPP konstaton se në përmbushje të kriterit kualifikues lidhur me fabrikën e Asfalto Betonit ankimuesi ka paraqitur Kontratë Qeraje Nr. 8289 Rep Nr.4283 Kol datë 22.10.2015 lidhur ndërmjet shoqërisë Malësia Ventur në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika në cilësinë e qeramarësit me objekt dhënia me qera e Linjës së inerteve dhe fabrikës së Asfalto Betonit me nr.pasurie 189/2 dhe me lejen mjedisore përkatëse. Koha e dhënies me qera do të jetë 3 vjet me të drejtë përsëritje në të ardhmen kohë e cila fillon sot më datën e nënshkrimit të kësaj kontrate 22.10.2015 deri më datë 22.10.2018. Akoma më tej konstatohet se në përmbushje të kapaciteteve teknike lidhur me makineri vjëzimi boje dhe makineri për spërkatje bitumi është dorëzuar Kontrata e Qerasë datë 01.07.2016 lidhur ndërmjet shoqërisë Shqiponja në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt Bitumatrice Makinë Vjëzimi me afat 3 vjecar nga data 01.07.2016-01.07.2019.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se afati i kontratave të qerave të sipërcituara nuk janë të vlefshme për te gjithë periudhën e realizimit të kontratës, KPP gjykon se duhet të mbajë në konsideratë parashikimet ligjore të përcaktuara në Kodin Civil ku parashikohet shprehimisht se:

Neni 659 “Përmbajtja e Kontratës”

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.

Neni 660

Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Neni 690

Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

Neni 821

Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit. Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.

III.1.10. Në interpretim literal të dispozitave të sipërcituara, KPP gjykon se kontratat janë veprime juridike të cilat lidhen me vullnet të lirë të palëve të cilët mund të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të lejuar me ligj. Kontratat lidhen duke respektuar disa kushte thelbësore të cilat janë shprehur qartësisht në ligj të tilla si pëlqimi i palës që merr përsipër një detyrim, të ketë një shkak të ligjshëm në të cilin mbështetet një detyrim, objekti i përcaktuar qartësisht si dhe aspekti formal që ka të bëjë me forma e kërkuar nga ligji.

Pra mjafton që kontrata të përmbushë këto kondita të nevojshme për të qenë tërësisht e vlefshme dhe ligjore. Elementë të tjerë shtesë sikundër në rastin konkret, afati i imponuar nga kriteri që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankim, është përtej parashikimeve ligjore duke anashkaluar kështu elementin me të rëndësishëm që karakterizon kontratën që është vullneti i lirë i palëve të cilët përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj.

KPP gjykon se kushti i përcaktuar në dokumentat e tenderit ka tejkaluar parashikimet ligjore pasi këto elementë nuk mund të varen rast pas rasti nga vullneti i autoritetit kontraktor në një procedurë prokurimi.

Kontrata e lidhur ndërmjet palëve është një veprim juridik, e cila referuar Kodit Civil, është “shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

Akoma më tej KPP gjykon se kontrata nuk përfundon vetëm në rastin e mbarimit të afatit të përcaktuar në të. Neni 690 parashikon se: Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj. Në interpretim literal të kësaj dispozite KPP gjykon se edhe nëse kontrata mund të ketë parashikuar një afat të caktuar ajo mund të prishet në cdo kohë me pëlqim të palëve ose për shkak se njëra palë nuk përmbush detyrimet që rrjedhin prej saj e cila mund të detyrojë palën tjetër të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të saj. Pra në këtë kuptim KPP gjykon se afati nuk është një garanci e dhënë njëherë e përgjithmonë që siguron autoritetin kontraktor se këto mjete do të jenë në dispozicion deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi.

III.1.11. KPP gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik të vërtetojë se disponon kapacitete në lidhje me eksperiencat e mëparshme, makineritë e pajisjet, punonjësit dhe personelin e duhur, etj., duke paraqitur dokumentacion të vlefshëm në datën e hapjes së procedurës duke realizuar edhe qëllimin e vendosjes së këtyre kriterëve, për të kualifikuar një shoqëri që plotëson të gjitha kriteret dhe

kërkesat e autoritetit kontraktor. Gjithashtu KPP konstaton se në kontratat e sipërcituara palët në kontratë kanë rezervuar të drejtën e ripërtëritjes së kontratës ose mundësinë e negociimit lidhur me zgjatjen e afatit. KPP gjykon se kontratat e sipërcituara janë të vlefshme në datën e zhvillimit të procedurës dhe ankimuesi dëshmon se disponon kapacitetet e nevojshme teknike për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Fakti që afati i kontratave përfundon përpara përfundimit të shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, nuk duhet të penalizojë subjektin duke i kufizuar atij të drejtën për të marrë pjesë dhe rrjedhimisht për t'u kualifikuar në të gjitha procedurat të cilat mund të zhvillohen gjatë kësaj periudhe në vazhdim dhe mund të zgjasin përtej afatit të vlefshmërisë së kontratës.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nika” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se *Freze , afati i kontrates , 1328 rep dhe 732 kol , date 09.07.2018 , notere B.B , me afat nga data, 09.07.2018, afati deri ne fund te vitit 2020 . Kjo kontrate noteriale nuk garanton kriterin e kerkuar ne dts ” Në rastin e mjeteve te tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizmi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi . Pra kontrata e qerase 1328 rep dhe 732 kol , date 09.07.2018 , notere B.B ,megjithese eshte e vlefshme e per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi per permbushjen e kapacitetin per freze asfalti nuk eshte paraqitur dokumenti perkates qe mund te jene faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit te kerkuar ne dst”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 8 pika 2.3.8 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. Si dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se zotëron :

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
17.	Mjet Germimi	ne pronesi ose me qera	cope 2
18.	Mjet Transporti vetëshkarkuese	ne pronesi ose me qera	cope 4
19.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 1
20.	Rrul vibrues	ne pronesi ose me qera	cope 1
21.	Prerese asfalti (sharre asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1

22.	Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 1
23.	Asfaltoshtruese	ne pronesi ose me qera	cope 1
24.	Makineri per sperkatje bitumi	ne pronesi ose me qera	cope 1
25.	Mjete per vendosje parmakesh metalik (guardraila) (Batipal)	ne pronesi ose me qera	cope 1
26.	Fabrike Asfaltobetoni	ne pronesi ose me qera ose me kontrate furnizimi	cope 1
27.	Skarifikuese (freze asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1
28.	Kamionçine ≥ 1.5 ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
29.	Mjet per vijezim me boje	ne pronesi ose me qera	cope 1
30.	Cilinder vibrues per mbushjen e gropave 1.5 – 2 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
31.	Mjet motorrik per prerjen e bimesise	ne pronesi ose me qera	cope 2
32.	Automjet borepastrues (APV) ose agregatë per pastrimin e bores dhe shperndares kripe me kamion ne dispozicion	ne pronesi ose me qera	cope 2

Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes **ose / dhe** kontratat e shitblerjes **ose / dhe** aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale , faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes **ose /dhe** aktet e zhdoganimit.

Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit).

III.2.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi janë bërë ndryshimet si më poshtë:

Nën pika 2.3.8 e kapacitetit teknik , **ishte** : “ Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes **ose / dhe** kontratat e shitblerjes **ose / dhe** aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale , faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes **ose /dhe** aktet e zhdoganimit.Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i

ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit). ”

Nënpika 2.3.8 e kapacitetit teknik , **ndryshohet** : “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit. Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi ”.

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Nika” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër në drejtim të vërtetimit të disponueshmërisë së pajisjes *Prerese asfalti (sharre asfalti)* ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Qeraje Mjeti Nr. 1328 Rep, Nr. 732 Kol datë 09.07.2018 lidhur ndërmjet Rrok Gega përfaqësues i shoqërisë Rroku Guest shpk në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Nika shpk me objekt Frezë Asfalti sipas deklaratës doganore
- Deklaratë Doganore datë 16.02.2010

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”

III.2.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon ”

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e kapaciteteve teknike lidhur me pajisjen : *Prerese asfalti (sharre asfalti) një copë*. Gjithashtu në kriter kërkohej shprehimisht se. *Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qera/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi ”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorit ekonomik “Nika” shpk konstatohet se në përmbushje të këtij kapaciteti ankimesi ka paraqitur kontratën e qersë lidhur me subjektin “Rroku Guest” shpk si dhe deklaratën doganore përkatëse.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ankimuesi ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, duke e plotësuar kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër analizuar, konstatohet se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimesi është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatorit ekonomik ankimesi disponon prerësen e asfaltit nëpërmjet kontratës së qerasë për të cilën ka paraqitur dhe deklaratën doganore përkatëse në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-73369-06-05-2018 me objekt “*Mirëmbajtje me performancë K/Sauk – Senatorium, K/Sauk – Ibë, Ibë – Qafë Krrabë (Km 29), Qafë Krrabë (Km 29) – rot. re Shijon, rot. re Shijon – Ura e Zaranikës, K/Km 22 – Qytezë Krrabë, Qytezë Krrabë – Pika Sipër Radio, Degëzim Miniera – Objekti X, Rotondo Sauk – Sauk i Vjetër, Tiranë – Ndroq – Romanat (Kufi Durrës), Romanat (kufi TR) – Plepa, Ura e Farkës – Qendër Fshat Baldushk, Qendër Fshat Baldushk – Mustafa Koçaj , K/Rr. Nr. 56 (Vaqqarr) – Vishaj (k/Baldushk) (116.25 km) (Kontrata 3)*”, me fond limit 53.431.283 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 09.07.2018 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qendror Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Nika” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nika” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1411 Protokolli; Datë 17.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha